



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 2 shkurt 2015  
Nr. ref.: RK765/15

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI97/14**

Parashtrues

**Velibor Jokić**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 610/2013, të 23 tetorit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Velibor Jokić, me vendbanim në Serbi.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 610/2013, të 23 tetorit 2013, me të cilin ishte hedhur poshtë ankesa e tij si paditës subsidiar. Ky aktvendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 4 shkurt 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës së Apelit i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, thirret në nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe në nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (b) të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 4 qershor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 4 korrik 2014, Kryetari caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 18 nëntor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Apelit të Kosovës.
8. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Faktet e rastit**

### ***Sa i përket kërkesave pronësore të parashtruesit të kërkesës***

9. Nga shkresat e rastit rrjedh se parashtruesi i kërkesës pretendon pronësinë e dy parcelave të tokës, që gjenden në komunën e Vitisë. Me sa duket, pronësia e parashtruesit u konfirmua nga Gjykata Komunale në Viti, në vitin 1994.
10. Më 11 mars 2004, parashtruesi paraqiti një kërkesë në Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Vitisë, duke

kërkuar regjistrimin e pronësisë së tij të këtyre dy parcelave në kadastrën komunale. Megjithatë, kjo kërkesë nuk është zbatuar. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Komunale e Vitisë që ta detyrojë përmbarimin e kërkesës së tij.

11. Më 11 janar 2008, Gjykata Komunale e Vitisë e aprovoi kërkesën për përmbarim të dhunshëm. Megjithatë, më 24 shtator 2008, drejtori i administratës së Komunës së Vitisë, X. S., refuzoi kërkesën e parashtruesit. Duket se, më 6 mars 2008, me Vendimin nr. 01-013/838, Kuvendi Komunal i Vitisë kishte urdhëruar pezullimin e përkohshëm të transferimit të regjistrimit të pronave që janë aktualisht të regjistruara në emrat e ndërmarrjeve shoqërore ose të ndërmarrjeve publike, që të regjistrohen në emrat e individëve privatë.
12. Parashtruesi i kërkesës kishte ndërmarrë hapa të ndryshëm ligjorë kundër refuzimit për të regjistruar pronat në emër të tij. Duket se këto procedura të ndryshme janë ende në pritje, por ato nuk janë objekt i kësaj kërkesë.

### ***Sa i përket ndjekjes penale të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës***

13. Më 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti kallëzim penal kundër drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë. Parashtruesi vetë paraqitej si "paditës subsidiar" sipas kapitullit V të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (UNMIK/REG/2003/26, siç ishte ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-003 të 6 nëntorit 2008). Parashtruesi i kërkesës akuzoi drejtorin e administratës për veprën penale "Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit", sipas nenit 339, paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (UNMIK/REG/2003/25, ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-002 të 6 nëntorit 2008).
14. Më 12 tetor 2012, me Aktvendimin UO. nr. 48/2009, Gjykata Komunale në Viti vendosi ta refuzojë aktakuzën e parashtruesit kundër drejtorit të administratës, sepse veprimi për të cilin ai ishte i akuzuar, nuk përbënte vepër penale. Gjykata komunale konsideroi se drejtori i akuzuar i administratës ishte thjesht duke e zbatuar vendimin e Kuvendit Komunal, të 6 marsit 2008.
15. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër këtij vendimi te Kolegji në përbërje të plotë të Gjykatës. Parashtruesi i kërkesës argumentoi se ai kishte dorëzuar kërkesën e tij për regjistrimin e pronave më 11 mars 2004, ndërsa Kuvendi Komunal i Vitisë nuk kishte vendosur të pezullojë përkohësisht regjistrimin e pronave deri më 6 mars 2008. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se dështimi për të regjistruar pronat në emrin e tij gjatë 4 (katër) vjetësh para vendimit të Kuvendit Komunal përbënte vepër penale të shpërdorimit të pozitës.
16. Më 15 maj 2013, me Aktvendimin UO. nr. 48/2009, Gjykata Themelore në Gjilan, dega në Viti, vendosi ta refuzojë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Gjykata Themelore konsideroi se drejtori i administratës thjesht përmbaroi vendimin e Kuvendit Komunal dhe nuk kishte keqpërdorur në asnjë mënyrë tjetër pozitën ose autorizimin e tij. Parashtruesi parashtrroi ankesë kundër këtij vendimi.

17. Më 23 tetor 2013, me Aktvendimin PN. nr. 610/2013, Gjykata e Apelit vendosi që ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte e pabazuar. Gjykata e Apelit konkludoi:

*“Kjo Gjykatë gjeti se në rastin konkret ankesa është e pabazuar dhe se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e [parashtruesit të kërkesës], me të cilën kishte propozuar anulimin e aktvendimit të Gjykatës Komonale të Vitisë, [...] sepse [drejtori i Administratës], me cilësi të personit përgjegjës, ka vepruar në përputhje me vendimin e KK të Vitisë [...], me të cilin ishte pezulluar përkohësisht regjistrimi mbi personat fizikë i paluajtshmërive të evidencuara në emër të ish-ndërmarrjeve shoqërore”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, thirret në nenet 6, 13 dhe 14 KEDNJ, si dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se e drejta për gëzimin paqësor të pronës së tij nuk është mbrojtur nga autoritetet publike dhe gjykatat. Për më tepër, ai pretendon se, duke refuzuar aktakuzën e tij të ndjekjes subsidiare, gjykatat i kanë mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën e qasjes në drejtësi.
20. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat nuk kanë dhënë arsye për vendimet e tyre, duke shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë. Ai pretendon se i është mohuar e drejta për barazi me palën tjetër në procedurë dhe se ai nuk ka përfituar nga një gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

21. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
22. Gjykata, gjithashtu, duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit. Neni 113, paragrafi 7 përcakton:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

23. Vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN. nr. 610/2013 të 23 tetorit 2013, kundër të cilit nuk lejohet ankesa e

mëtejshme. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit.

24. Parashtruesi i kërkesës duhet gjithashtu të dëshmojë se i ka plotësuar kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me parashtrimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës mund të shihet se vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN. nr. 610/2013, i 23 tetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 4 shkurt 2014, ndërsa parashtruesi paraqiti kërkesën në Gjykatë më 4 qershor 2014, që do të thotë se kërkesa është paraqitur brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të paraparë me Ligj dhe me Rregullore të punës.

### ***Sa i përket qasjes në mjete gjyqësore***

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i është mohuar qasja në mjetet gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tij pronësore. Parashtruesi pretendon se atij i është mohuar e drejta për gëzimin paqësor të pronës së tij, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.
26. Gjykata vëren se procedurat e ndryshme juridike dhe gjyqësore janë përmendur në shkresa të lëndës, por asnjë nga këto procedura nuk është shpjeguar ose shtjelluar. Asnjë kopje e vendimeve në procedurat e tilla nuk janë në shkresat e lëndës. Në të vërtetë, duket se të paktën disa nga këto procedura ende mund të jenë në pritje. Për më tepër, Gjykata vëren se procedurat të cilat janë objekt i kësaj kërkesë, nuk kanë asnjë ndikim në të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gëzimin paqësor të pasurisë së tij, por kanë të bëjnë me një akuzë penale kundër një zyrtari publik për keqpërdorim të pozitës.
27. Në këtë mënyrë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur në baza kushtetuese pretendimet e tij në lidhje me të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore dhe të drejtën për mjete juridike, dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.
28. Rregulli 36 (2) d) i Rregullores së punës, parasheh që *“Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.

### ***Sa i përket të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe gëzim të pronës***

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ka përfituar nga një gjykim i drejtë, në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.
30. Neni 31 i Kushtetutës, në pjesën përkatëse të paragrafit të dytë të saj, parashikon se,

*“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale [...]”*

31. Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, në pjesët përkatëse, parashikon,

*“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht [...]”.*

32. Përveç kësaj, neni 53 i Kushtetutës parasheh që:

*“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

33. Gjykata vëren se ankesa e parashtruesit në lidhje me një gjykim të drejtë ka të bëjë ekskluzivisht me procedurën penale kundër një pale të tretë në të cilën kishte paraqitur veten si paditës subsidiar. Akuza e parashtruesit të kërkesës kundër palës së tretë ishte refuzuar nga gjykata e shkallës së parë dhe nga Gjykata e Apelit me arsyetim se akuzat kundër kësaj pale të tretë nuk përbëjnë vepër penale.

34. Gjykata vëren se, në qoftë se këto procedura penale do të ishin lejuar të vazhdojnë, rezultati i tyre do të mund të përfundonte vetëm me një vërtetim të akuzave penale të paraqitura kundër kësaj pale të tretë. Nuk kishte akuza penale të paraqitura kundër parashtruesit të kërkesës.

35. Kur të lexohet neni 31 i Kushtetutës, në dritën e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se shprehja *“për cilëndo akuzë penale”*, siç përdoret në nenin 31, duhet të kuptohet si *“për cilëndo akuzë penale të ngritur kundër parashtruesit të kërkesës”*. Në këtë mënyrë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë nuk mund të bie brenda fushëveprimit të titullit *“për cilëndo akuzë penale”*, të përfshirë në nenin 31 të Kushtetutës.

36. Për më tepër, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet, Gjykata rikujton Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut në rastin *Perez kundër Francës* (nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004), i cili, në paragrafët 70 dhe 71, thotë që,

*“70. [Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut] vëren se Konventa nuk jep asnjë të drejtë, siç kërkohet nga parashtruesi i kërkesës, për “hakmarrje private” apo për një actio popularis. Kështu, e drejta për të ndjekur penalisht palët e treta apo për të dënuar për një vepër penale nuk mund të realizohet në mënyrë të pavarur: ajo duhet të jetë e pandashme nga ushtrimi një të drejte të viktimës për të ushtruar të drejtën për procedurë civile në të drejtën vendore, edhe në qoftë se kjo është vetëm për të siguruar dëmshpërblim simbolik ose për të mbrojtur një e drejtë civile siç është e drejta për një “reputacion të mirë” [...].*

*71. Gjykata [Evropiane] arrin në përfundimin se një ankesë civile e palës bie në kuadër të fushëveprimit të nenit 6 § 1 të Konventës, **përveç në rastet e përmendura në paragrafin e mëparshëm**”.* [Theks i shtuar]

37. Për dallim nga rasti *Perez kundër Francës*, parashtruesi nuk ishte palë civile në një ndjekje penale, por vetë kishte filluar procedurën penale si paditës subsidiar. Nga shkresat e lëndës mund të shihet se këto procedura penale nuk kanë përfshirë kërkesën për kompensim të çfarëdo dëmi të pësuar nga parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, këto procedura penale nuk mund të kishin ndikuar në rezultatin e ndonjë procedure tjetër juridike lidhur me të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës. Në këtë mënyrë, rezultati i ndjekjes penale kundër drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë nuk do të kishte ndikuar në gëzimin e ndonjë të drejte nga ana e parashtruesit, dhe as nuk do të kishte përcaktuar ndonjë detyrim të parashtruesit të kërkesës.
38. Siç u citua më lart në Aktgjykimin *Perez kundër Francës*, GJEDNJ nuk siguron të drejtën e ndjekjes ose dënimit të një pale të tretë për një vepër penale. As Kushtetuta nuk ofron një të drejtë të tillë.
39. Duke pasur parasysh se procedurat ndaj të cilave ankohet nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e çfarëdo të drejte dhe obligimi të parashtruesit të kërkesës, rrjedh se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë nuk bie brenda fushëveprimit të titullit "*të drejtat dhe obligimet*", të përfshira në nenin 31 të Kushtetutës.
40. Në përfundim, Gjykata konstaton se ankesat e parashtruesit në lidhje me procedurën penale kundër drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë nuk i takojnë fushëveprimit të së drejtës për gjykim të drejtë, nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së.
41. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi ankohet se është shkelur e drejta e tij për gëzim paqësor të pronës, për shkak të refuzimit të gjykatave të rregullta për të lejuar ndjekjen e tij subsidiare kundër drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë. Megjithatë, siç përshkruhet më lart, këto procedura nuk kishin asnjë ndikim në të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës.
42. Prandaj, Gjykata gjen se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtave të tij pronësore nuk i takojnë fushëveprimit të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, sepse gëzimi i të drejtave të tij pronësore, nuk ka mundur në asnjë mënyrë të preket nga këto procedura.
43. Prandaj, Gjykata konsideron se ankesat e parashtruesit në lidhje me të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të drejtën e tij për mbrojtje të pronës nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
44. Rregulli 36 (3) (e) i Rregullores së punës parasheh që "*Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: [...] kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;*

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) d), 36 (3) e), dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 8 dhjetor 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Arta Rama-Hajrizi



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani